

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NDËRMJET AUTORITETIT KOMBËTAR PËR
MENAXHIMIN DHE RREGULLIMIN E KOMUNIKIMEVE TË RUMANISË DHE
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË PËR TË SIGURUAR BASHKËPUNIMIN DHE SHKËMBIMIN E
INFORMACIONIT NË FUSHËN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE SHËRBIMEVE
POSTARE**

**AUTORITETI KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN DHE RREGULLIMIN E KOMUNIKIMEVE
I RUMANISË**

dhe

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË ,**

më poshtë i referohemi si *Palët*,

duke njohur marrëdhëniet e shëndosha të bashkëpunimit ndërmjet të dy Palëve,

duke njohur interesin e ndërsjelltë në krijimin e partneritetit bashkëpunues në fushën e rregullimit të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare,

duke konsideruar faktin se bashkëpunimi ndërmjet të dy Palëve do të kontribuonte në zhvillimin e praktikave rregullatore të qëndrueshme në këto fusha të veçanta,

të bindur se bashkëpunimi përmes shkëmbimit të informacionit në këto fusha të interesit të përbashkët do të sjellë përfitim të ndërsjelltë,

të vetëdijshëm ndaj faktit se një bashkëpunim i tillë në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare do të lehtësojë zhvillimin e marrëdhënieve të mëtejshme ndërmjet Palëve,

me dëshirën për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare,

bien dakord si vijon:

NENI 1

Objektivi i Bashkëpunimit

- (1) Objektivi kryesor i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është të vendosë kuadrin e nevojshëm për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet të dy Palëve, në përputhje me fuqitë e tyre ligjore në fushën e rregullimit dhe monitorimit të aktiviteteve në sektorët e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare. Për këtë qëllim, Palët kanë të drejtë të ndërmarrin aktivitete të përbashkëta.
- (2) Bashkëpunimi ka si qëllim kryesor të promovojë shkëmbimin e informacionit lidhur me kuadrin ligjor që zbatohet në sektorët e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe shkëmbimin e eksperiencës lidhur me rregullimin dhe konsultimin në këto fusha.
- (3) Palët presin që ky bashkëpunim të mbështesë aktivitetet rregullatore të ndërmarra nga të dy Palët me qëllim promovimin e konkurrencës në sektorët e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare dhe në interes të përdoruesve fundorë, në përputhje me praktikat më të mira Europiane dhe ndërkombëtare.

NENI 2

Fushat e Bashkëpunimit

Në mënyrë që të rritet kapaciteti institucional i Palëve, drejtimet kryesore të bashkëpunimit ndërmjet të dy Palëve do të mbulojnë këto fusha:

- a) Rregullimin e tregjeve në fushën e komunikimeve elektronike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 1. Analizën e tregut;
 2. Shërbimet brenda fushës së shërbimit universal dhe përcaktimin e ofruesve të shërbimit universal;
 3. Portabilitetin e numrit;
 4. Detyrimet e vendosura ndaj OFNT-ve, duke përfshirë detyrimet e zgjedhjes së bartësit dhe para-zgjedhjes së bartësit;
 5. Aksesin e hapur në qarkun dhe nën-qarkun lokal dhe aksesin bitstream në qarkun lokal;
 6. Rregullimin e tarifave dhe sistemeve të llogaritjes së kostove;
 7. Të Drejtën e Kalimit (Rights of Way) dhe përdorimin e përbashkët të infrastrukturës;
 8. Cilësinë e shërbimeve si dhe sigurinë dhe integritetin e rrjeteve apo shërbimeve;
 9. Mbrojtjen e përdoruesve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve;
 10. Administrimin dhe menaxhimin e burimeve të kufizuara;
 11. Aspekte teknike me ndikim në rregullim;
 12. Strategjitë afat-mesme apo afat-gjata.
- b) Shkëmbimin e eksperiencës në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare;
- c) Organizimin e seminareve, konferencave dhe forumeve të përbashkëta, si dhe pjesëmarrjen me stenda ekspozimi në evente specifike lidhur me fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

- d) Organizimin nga palët të konsultimeve dhe ekspertizave të përbashkëta me qëllim promovimin, bashkëpunimin në kuadër të, dhe realizimin e shkëmbimit të eksperiences në atë fushë aktiviteteve që janë specifike për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare;
- e) Promovimin e një mjedisi konkurrues në fushat e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare;
- f) Parandalimin e veprimeve të cilat kanë si objekt apo efekt deformimin ose kufizimin e konkurrencës në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare;
- g) Përmirësimin e kapaciteteve institucionale për të dy Palët;
- h) Promovimin e inovacioneve teknike në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare;
- i) Bashkëpunimin me institucionet ose organizatat e tjera ndërkombëtare me aktivitete në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare;
- j) Promovimi i iniciativave të përbashkëta apo rajonale në këtë fushë brenda limiteve të kompetencave për të dy Palët.

NENI 3

Instrumentat e Bashkëpunimit

- (1) Instrumentat e bashkëpunimit ndërmjet Palëve janë si vijon:
- a) a)shkëmbimi i informacionit dhe dokumentave jo konfidenciale apo të pa-klasifikuara të natyrës profesionale, që janë rezultat i aktivitetit të Palëve;
 - b) organizimi i konsultimeve bilaterale, si në nivel menaxherial ashtu dhe në nivel ekspertësh me qëllim studimin e aspekteve teknike, ligjore dhe të tjera të aktiviteteve kombëtare rregullatore;
 - c) vendosja e pikave të kontaktit dhe e mekanizmave të komunikimit me qëllim arritjen e objektivit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, duke përfshirë dhe ngritjen e grupeve të ekspertëve;
 - d) pjesëmarrja në evente të mbajtura në të dy vendet, duke përfshirë workshop-e, seminare, vizita studimore;
 - e) informimi i ndërsjellë dhe dërgimi i ftesave për simpoziume ndërkombëtare dhe konferenca të organizuara nën patronazhin e tyre;
 - f) pjesëmarrja në aktivitete të grupeve rajonale të punës në fushën e komunikimeve elektronike – Grupi Rajonal i Punës i Europës Lindore Qëndrore – duke përfshirë promovimin e imazhit të këtij të fundit, duke i dhënë mbështetje respektive çdo iniciative të këtij lloji, të lançuar apo të përkrahur nga një nga Palët; çdo event rajonal në fushën e komunikimeve elektronike që organizohet nga secila Palë do të përfshijë një seancë dedikuar grupit rajonal të punës - Grupi Rajonal i Punës i Europës Lindore Qendrore;
 - g) inkurajimi i zbatimit të praktikave më të mira rregullatore në sektorët e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare;
 - h) analiza e rasteve studimore relevante në fushat e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare;
 - i) të tjera forma bashkëpunimi me të cilat Palët bien dakord, në bazë të propozimeve specifike bashkëpunimi, si shprehje e koordinimit në të ardhmen të veprimtarive të përbashkëta të të dy Palëve.

(2) Të dy Palët do të takohen në baza dy-vjeçare për të vlerësuar progresin e bërë, për të vendosur prioritetet për bashkëpunim brenda kuadrit të mandatit të ardhshëm dhe, nëse shihet e arsyeshme, për të konsideruar qëndrime të reja me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit, apo për të eksploruar sinergji të reja. Gjithashtu, të dy Palët mund të bien dakord për veprime dhe pozicione të përbashkëta në nivel Europian dhe çdo organizate tjetër ndërkombëtare lidhur me sektorët e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Neni 4 Çështjet Financiare

- (1) Secila Palë do të përballojë kostot e saj që vijnë si rezultat i aktiviteteve të zhvilluara në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
- (2) Veprimtaritë e bashkëpunimit të specifikuar në këtë Memorandum Mirëkuptimi do të zhvillohen në varësi të fondeve financiare si dhe burimeve të tjera të disponueshme të Palëve.
- (3) Në rastet kur masat e marra për implementimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi mund të sjellin detyrime financiare apo ligjore, përpara miratimit të këtyre masave, Palët do të miratojnë një marrëveshje të veçantë, në varësi të rregullave dhe rregulloreve për fondet financiare të Palëve.

Neni 5 Amendime

- (1) Palët mund të ndryshojnë këtë Memorandum Mirëkuptimi nëpërmjet akteve shtesë.
- (2) Aktet shtesë të përmendura në paragrafin (1) do të miratohen në formë të shkruar dhe do të bëhen pjesë integrale e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, duke zbatuar përkatësisht dispozitat e nenit 7.

NENI 6 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- (1) Palët angazhohen në respektimin me përpikmëri dhe mirëbesim dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
- (2) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve që lidhet me ekzekutimin, interpretimin e ndërsjelltë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet miqësisht, në kohën më të shkurtër të mundshme.

Neni 7

Dispozita Përfundimtare

- (1) Ky Memorandum Mirëkuptimi ka një periudhë vlefshmërie prej 1 viti dhe hyn në fuqi ditën që përmbyllet nga të dyja Palët.
- (2) Ky Memorandum Mirëkuptimi do të rishihet në heshtje për periudha të njëpasnjëshme prej 1 viti, me përjashtim të rasteve kur një nga Palët i dërgon Palës tjetër një njoftim me shkrim për përfundimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, të paktën 30 ditë përpara përfundimit të periudhës së vlefshmërisë.
- (3) Secila Palë mund të përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim, dhe përfundimi prodhon efekte brenda një muaji nga njoftimi i Palës tjetër.
- (4) Nëse përfundimi i Memorandumit është njoftuar, Palët duhet të marrin masa të menjëhershme për përmbylljen e të gjitha aktiviteteve të përbashkëta, në një mënyrë të drejtë dhe pa vonesa.
- (5) Asnjë dispozitë e këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk vendos detyrime ligjore për secilën Palë, dhe nuk duhet të interpretohet në mënyrë të ngjashme me dispozitat ligjore ndërkombëtare si dhe nuk jep të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga ligji ndërkombëtar, respektivisht.

Nënshkruar më në në dy kopje origjinale secila në gjuhët zyrtare të vendeve - Rumanisht dhe Shqip – dhe Anglisht, ku të gjitha tekstet do të jenë njëloj të vlefshme. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje për shkak të përkthimit, versioni i shkruar në gjuhën Angleze do të merret parasysh.

**Në emër të Autoritetit Kombëtar për
Menaxhimin dhe Rregullimin e
Komunikimeve të Ruamnisë
ANCOM
Rumani**

**Në emër të Autoritetit të
Komunikimeve Elektronike dhe
Postare të Republikës së Shqipërisë
AKEP
Shqipëri**

**Marius Cătălin Marinescu
President**

**Piro Xhixho
Kryetar**